



Azienda USL Toscana Centro  
DEPARTAMENTI I PARANDALIMIT TË  
SEMUNDJEVE  
Njësia Funkzionale e Higjenës  
Publike dhe e Sigurisë Ushqimore  
Zona e Empolit



Data: \_\_\_\_\_

Praktika N. \_\_\_\_\_

Zotit/Zonjës \_\_\_\_\_

Rruga \_\_\_\_\_

Adresa email \_\_\_\_\_

### Masat profilaktike kundër përhapjes së sëmundjes ngjitëse COVID-19

**URDHËRESA** për respektimin e masave të izolimit.

**Në bazë të** normativave të fundit kombëtare dhe rajonale për ti bërë ballë emergjencës epidemike nga COVID-19 nëpërmjet përdorimit të masave parandaluese dhe kufizuese ndaj përhapjes së këtij virusi;

**Duke qënë në njohje të faktit që Z./Znj.** \_\_\_\_\_ **K.F.** \_\_\_\_\_ lindur në datën \_\_\_\_\_ **dhe me banesë në rrugën** \_\_\_\_\_ **n.** \_\_\_\_\_ **qyteti** \_\_\_\_\_

**Tel.** \_\_\_\_\_ ka patur komunikime apo lidhje të ngushta me një **RAST TË MUNDSHËM/TË VËRTETUAR** me një person të infektuar nga COVID-19 (ky i fundit ka patur përgjigje pozitive nga analiza e parë dhe është në pritje të vërtetimit nga ana e Institutit të Lartë të Shëndetësisë);

### URDHËROJ

**Qëndrimin i tij/saj në karantinë deri në datën** \_\_\_\_\_ **2021** (dita e katërbëdhjetë që nga dita në të cilën ka patur kontakt me rastin e infektuar apo të dyshuar, që ka qënë \_\_\_\_\_) **ose deri në datën** \_\_\_\_\_ **2021** (10 ditë që nga dita në të cilën ka patur kontakt me rastin e infektuar apo të dyshuar, pas përgjigjes negative të analizave molekulare të shpejta apo të atyre të antigjenit). Gjatë karantinës duhet të respektojë urdhëresën e bashkangjitur, është i detyruar ti përgjigjet telefonatave të personelit të posaçëm, si dhe ti komunikojë menjëherë mjekut të familjes çdo ndryshim të gjëndjes shëndetësore ose shfaqjen e simptomave.

**NË RAST SE SIMPTOMAT JANË ATO TË COVID-19 DO TË NDËRMERREN DHE DO TË ZBATOHEN TË TJERA MASA TË POSAÇME.**

Mos respektimi i masave të mësipërme do të dënohet sipas ligjeve në fuqi. Të dhënat tuaja personale dhe të ndjeshme do të trajtohen dhe ruhen mbi bazën e masave të sigurisë që parashikohen nga normativa.

Me respekt.

Drejtori i  
Departamentit të Higjenës Publike  
dhe Sigurisë Ushqimore Zona Empoli  
Dr.FILIDEI PAOLO

Azienda USL Azienda USL Toscana Centro – sede legale:



Azienda USL Toscana Centro  
DEPARTAMENTI I PARANDALIMIT TË  
SEMUNDJEVE  
Njësia Funkzionale e Higjenës  
Publike dhe e Sigurisë Ushqimore  
Zona e Empolit



## KARANTINA SHTEPIAKE

Në lidhje me mundësinë e ekspozimit ndaj infektimit nga Covid-19, japim informacionet e mëposhtme.

Rekomandimet, në bazë të normave në fuqi janë:

### Vëreni në mënyrë të skrupullt masat higjenike që vijojnë:

- mbajtja e higjenës së duarve (lajini shpesh duart me ujë dhe sapun ose me solucionet e posaçme alkalike);
- higjena e rrugëve të frymëmarrjes (kollituni apo tështini në një shami një përdorimshe ose mbi bërrylin e përthyer, hidheni menjëherë shaminë e përdorur në një kosh me kapak që duhet mbyllur menjëherë pas hedhjes së shamisë dhe lani duart);
- ajrosni shpesh ambientin për të bërë të mundur ndërrimin e ajrit;
- përdorni maskën kirurgjike të fytyrës;
- pastroni çdo sipërfaqe dhe çdo send që ka qënë në kontakt me pacientin me alkol etilik 70% ,me ujë dhe lëndë larëse apo me çdo lloj tjetër dezinfektanti të posaçëm për pastrimin e ambienteve dhe sipërfaqeve të tyre.
- **kontrolloni 2 herë në ditë**, në mëngjes dhe në darkë, temperaturën e trupit dhe bëni kujdes nëse shfaqen simptomat: temperaturë, kollë, dhimbje fyti, vështirësi në frymëmarrje, dhimbje muskujsh, diare, ndryshimi i shijes, pakësimi apo humbja e nuhatjes, hundët e zëna.

Në rast se keni simptomat e mësipërme **NJOFTONI MENJËHERË MJEKUN E FAMILJES** dhe nëse gjëndja e përgjithshme keqësohet e veçanërisht frymëmarrja, rekomandohet:

- Mos kërkoni të shkoni tek mjeku apo në spital me mjetet tuaja;
- Telefononi mjekun ose ndihmën e shpejtë, urgjencën, në n° 118.

Pas karantinës prej 14 ditësh, ose 10 ditësh në rastin e pergjigjes negative të testit të antigjenit apo atij molekular të shpejtë, në mungesë të simptomave, mund të ndërmerret rutina e përditshme, pra edhe frekuentimi i shoqërisë dhe kolektivitetit të punës/shkollës edhe pa aprovimin nga ana e këtij departamenti.

Azienda USL Azienda USL Toscana Centro – sede legale: